



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 gusht 2016
Nr. ref.:RK976/16

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI40/16

Parashtrues

Sokol Plakolli

**Kërkesë për vlerësim të shkeljeve të papërcaktuara të Kushtetutës së
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Sokol Plakolli nga fshati Letanc, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit që Gjkata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), *“urgjentisht të ndërmarre masa konkrete për pezullimin e punës”* së një Qendre (Qendra M) si dhe të iniciojë *“procedurë penale ndaj udhëheqësve”* të kësaj Qendre.
4. Parashtruesi nuk ka përmendur asnjë të drejtë apo liri të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), e cila mund t’i jetë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (4) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 shkurt 2016, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 14 mars 2016, Kryetarja caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 26 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 14 qershor 2016, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht hedhjen poshtë të saj në bazë të rregullit 32 (4) të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

10. Gjykata, përveç pretendimeve të parashtruesit të përmbledhura në një të ashtuquajtur *“letër të hapur”*, nuk ka pranuar asnjë fakt apo të dhënë tjetër lidhur me këtë rast.
11. Parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë informatë apo dëshmi që tregon se ai ka iniciuar ndonjë procedurë ligjore apo që ka ndërmarre ndonjë veprim tjetër për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi nuk ka kontestuar asnjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik dhe nuk ka përmendur asnjë të drejtë apo liri të garantuar me Kushtetutë që mund t'i jetë shkelur.
13. Parashtruesi i është drejtuar Gjykatës me një të ashtuquajtur "letër të hapur" përmes së cilës shpreh pakënaqësinë dhe konteston punën e Qendrës në fjalë dhe ndër të tjera, thekson: *"Duke u ballafaquar me sfida të shumta kam hetuar shkelje klasike të Kushtetutës së Kosovës. Andaj kam vendosur të ju drejtohem juve si institucion i cili e ka për detyrë të mbrojë Kushtetutën e Kosovës dhe të trajtojë shkeljet e mundshme kushtetuese nga individë dhe institucione apo organizata qofshin ato qeveritare apo joqeveritare"*.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

16. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

17. Më tutje, Gjykata i referohet rregullit 29 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;

(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës".

18. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka përmbushur asnjë nga kushtet e kërkuara me dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës, të Ligjit dhe të Rregullores së punës.

19. Më konkretisht, Gjykata vëren se parashtuesi përveç kërkesës të tij të përgjithshme dhe abstrakte, ai i) nuk ka kontestuar asnjë vendim të ndonjë autoriteti publik; ii) nuk ka dëshmuar se ndonjëra nga të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur nga ndonjë autoritet publik; iii) nuk ka paraqitur asnjë fakt apo të dhënë lidhur me rastin e tij; iv) nuk ka paraqitur asnjë arsyetim procedural ose substantiv të kërkesës së tij; si dhe, v) nuk ka paraqitur asnjë informacion ose dokumentacion mbështetës.
20. Në dritë të këtyre fakteve, Gjykata i referohet edhe rregullit 32 (4) (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest dhe nuk ka rrethanë të veçantë lidhur me të drejtat e njeriut dhe/ose interesin publik në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë kërkesën”.*
21. Lidhur me këtë, Gjykata konkludon se kërkesa në fjalë nuk përfaqëson një rast ose kontest dhe nuk paraqet asnjë rrethanë të veçantë që lidhet me të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Si rrjedhojë, kërkesa në fjalë nuk mund të merret në shqyrtim meqë nuk plotëson asnjë nga kushtet procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës.
22. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të hedhet poshtë në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, si dhe rregullat 29 dhe 32 (5) të Rregullores së punës, më 14 qershor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi

